



Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, nenit 18, paragrafi 1 dhe 3, nenit 20, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Komuna e Prishtinës, shpallë këtë:

K O N K U R S

PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

DREJTORIA E KADASTRIT

POZITA: Udhëheqës i Shërbimit për rrjet dhe matje - një (1) ekzekutues

KOEFICIENTI : 7

LLOJI I POZITËS: i karrierës

POZITA FUNKSIONALE: nëpunës civil i nivelit drejtues

ORARI I PUNËS: 40 orë në javë

PËRGJEGJËSIA MBIKËQYRËSE : po

MBIKËQYRJA: Drejtori i drejtorisë

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :

- Organizon dhe koordinon punët e sektorit të gjeodezisë të cilat kanë të bëjnë me rrjetin gjeodezik dhe matjet e duhura;
- Përcjell punët e kryera të punëtorëve të sektorit të gjeodezisë si dhe mbikëqyr punën e evidentimit të lëndëve në data bazën e Drejtorisë së Kadastrit;
- Në bashkëpunim me shefin e Sektorit bëjnë hartimin e planeve të Sektorit të gjeodezisë;
- Koordinon dhe mbikëqyrë realizimin e punëve që dalin nga fushë veprimtaria e sektorit;
- Më urdhër të drejtorit dhe të shefit të Sektorit kryen edhe punë tjera në kuadër të drejtorisë;
- Për punët e kryera i përgjigjet shefit të Sektorit dhe drejtorit të Drejtorisë.

Kushtet: Diplomë universiteti në Fakultetin e gjeodezisë, 4 vjet përvojë pune, njohja e punës me kompjuter dhe programe -Microsoft Office, Auto Cad e domosdoshme.

Data e shpalljes se Konkursit - 13.02.2015 deri me dt. 27.02.2015

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në objektin e komunës së vjetër.

Në aplikacion duhet te ceket qartë titulli i vendit te punë dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet te jenë kopje dhe nuk kthehen.

“ Shërbimi Civil i Komunës është në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mirëpret aplikime nga meshkujt dhe femrat e të gjitha komuniteteve të Kosovës “

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes për pozitën e cekur më lart.

KPSHC (Komisioni përzgjedhës i shërbimit civil) duke u bazuar në nenin 25 paragrafi 1 të Rregullores NR. 02/2010 për procedurat e rekrutimit të shërbimit civil, mund të verifikoi me institucionet përkatëse vërtetësinë e të dhënave të sigurta nga kandidatët.

Pas përgatitjes së listës së ngushtë të kandidatëve, këtyre kandidatëve do të ju kërkohen kopjet e dokumenteve të vërtetuara nga organi kompetent(diploma dhe kontrata e punës ose vërtetimi i përvojës e punës) nëse ato nuk janë dorëzuar të vërtetuara.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit.

Fletë aplikacionet e kandidatëve me dokumente të pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit, nuk do të merren në shqyrtim.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni me Njësinë e personelit, zyra nr. 40, në këtë nr. të telefonit 038 / 230 - 900 lokali 10 -70.